

SHOQERIA TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"D.F.S MARINE GROUP LTD " SHPK

DURRES – SHQIPERI

S T A T U T

KREU I:

EMERTIMI - OBJEKTI - SELIA - KOHEZGJATJA

NENI 1

Ne Durres, sot me daten 27 Nentor 2017 (dymije e shtatëmbëdhjete) dite e Hënë, une shtetasi:

1. Shtetasi **Z.FLORJAN DOMI**, atësia Hamdi, amësia Flutura, i datëlindjes 23.06.1989, lindur në Durrës dhe banues në L.17, Rr "Stef Kaçulini/Durrës , Cel:0696031280, identitetin e të cilit e verifikova me *Letërnjoftimin ID 024707816/190623078K* me afat deri me datë 26.03.2019 kam krijuar:

Shoqerine Tregtare me pergjegjesi te kufizuar **"D.F.S MARINE GROUP LTD " SH P K**
Durres – Albania.

NENI 2

Selia Qendrore e Shoqerise eshte ne adresen: Lagja 17 ,Rr"Stef Kaçulini"Durres ,Pasuria Nr.9/242,Zona Kadastrale 8513,Kati i III-të ,Vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit :Durres ,Lagja 1,Autoriteti Portual ,Agjensi Portuale.

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin tregetar ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit, ne çdo shtet tjetër te huaj.

Me Vendim te Asamblese se Pergjithshme, mund te krijohen ose anulohen (ne rast se jane çelur) Seli, Filiale Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte shtetit.

Njesite e tjera strukturore te Shoqerise, si Dege apo Perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve te huaja normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

NENI 4



Kapitali Themeltar i Shoqerise është në likuditet në shumën **500.000Lek** (pesëqindmijë) Lek i ndarë në **1 knote** me vlere nominative **1 knote/500.000Lek**, i formuar dhe nënshkruar nga unë Ortaku i vetëm **FLORJAN DOMI**.

Ortaku ka pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronësie mbi çdo lloj Kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjetër (te luajtshme apo te paluajtshme), te fituar ne rruge te ligjeshme.

Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

Ortaku ka te drejte te transferoj jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht ose teresisht kontributin e tij, perfshire fondet dhe vlerat e kontributit ne natyre bazuar ne te drejten qe i njej Ligji "Per Investimet e Huaja".

Shoqeria dhe te tretet, respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.

NENI 5

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me letra me vlere.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte **PA AFAT**, duke filluar ky afat nga dita e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

Me Vendim te Asamblese se Pergjithshme, kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoj dhe ky Vendim i dergohet menjehere per depozitim Qendres kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare.

NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarin e saj tregtare ne perputhje te plote me Legjislacionin shqipetar ne fuqi si dhe mbi bazen e Kontrates se Themelimit dhe ketij Statuti te saj.

NENI 8

Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne keto Drejtime:

1.Sherbime agjensi detare dhe te rekomandimeve detare :broker detar,ajeror dhe siguracionesh ,sherbime detare dhe ajrore :sherbime te transportit dhe te ngjashme me te ,sherbime spedicioni per ngarkesa te vogla dhe me mjete transporti vendase brenda dhe jashte shqiperise ;sherbime per aktivitet depozitimi dhe magazinimi i mallrave dhe i mjeteve ne magazainat ose depozitat nacionale ose te tjera ; pergatitjen e praktikave doganore ne pergjithesi per llogari te te treteve ,aktivitetet ne veprimet portuale,asistence dhe oraganizim i operacioneve te ngarkim/shkarkimit te mallrave dhe pasagjerve ;sherbime qe lidhen me aktivitet te komisarit te avarive dhe likujdatorit te avarive;organizimi i shkarkimit dhe levizjes se konteniereve dhe veprimtari turistike dhe tour operator.

2.Dhenje me qera ;ka te drejte te bashkepunoje me qellim fitimi ne ndermarje ose shoqeri te tjera te çfardo lloji,dpi dhe sido qe te jene krijuar ato;çdo lloj aktiviteti financiar ,tregetar,industrial ,ndertimi qe do te shihet ne interes te realizimit te objektit social te saj. Shoqeria gjithashtu ka te drejte te japi hua ,financime per te tretet per shoqeri qe lidhen me te ose per shoqerite qe kontrollohen nga vete oratket.Mund te mare ndihma ose

financime nga çfardo end publik ose privat ,shqipetar ose te huaj ,nga insitute bankare ose nga shoqeri qe lidhen me te ose qe kontrollohen nga ortaket.

3.Furnizim anijesh me materiale te ndryshme konsumi karburante ,lubrifikante si dhe te gjitha paisjeve te nevojshme per kryerjen e procesit teknologjik.

4.Trasportim dhe tregetim me shumice dhe pakice per import dhe eksport te mallrave te ndryshme industrial.

5.Trasportim dhe tregetim me shumice e pakice per import –eksport te kimikateve te ndryshme, etjer.

6.Sherbime me hotelerie dhe turistike te te gjithahve llojeve perfshire organizimin eskursionesh ,per udhetime tokesore ,ajroredhe detare ,pergatije biletash ,sherbime dhe rezervime hotelesh brenda dhe jasht vendit dhe transport turistesh brenda dhe territorit te republikes se Shqiperise ,marje dhe dhenije automjetesh me qera ,sherbimi me qellim promovimi dhe nxitjen e turizmit ,çdo aktivitete tjeter qe lidhet direkt apo indirekt me aktivitet e lartepemendura ,shkembim apo çdo trasaksion tregetar ne lidhje me pasurite e luajteshme dhe te paluajteshme ,shitje dhe blerje ,pjesemarrresh ne shoqeri ,dege,konsorciume ose ente te tjera ,garantimi dhe vendosja e barreve (mbi pasurite e luajteshme dhe paluajteshme),si dhe lidhja e çdo marreveshje finaciare.Aferimi i sherbimeve keshilluese ,zhvillimi i studimeve kerkimore te tregut ,krijimi i patentave dhe markave tregetare si dhe te drejta te tjera te pronesisë intelektuale ,themelimi dhe organizimi i rrjeteve tregetare ,lidhja e mareveshjeve te agjensise dhe sherbimit. Organizime te panairove turistike dhe pjesemarrje ne te.Sherbime estektike dhe parukerie ,tregeti te artikujve te parukerise me shumice dhe pakice ,shitje suveniresh dhe artikuj industrial,kembim valute.

7. Projektme dhe menaxhim ne dhenien e asistences teknike per realizimin, ndertimin,rikonstruksion ,riparime dhe sherbime teknike periodike,te anijeve,tregeteve dhe mjeteve te ndryshme te lundrimit detar dhe ujor,te çdo tonazhi,si per vehte dhe te treteve dhenien konsulences dhe kryerje sherbimi per kontrollin dhe perpunimin e anijeve te ankoruara ne porte. Menaxhim per blerje, shitje, armim, crawing, kryerjen e sherbimeve tekni ISM dhe ISPA per anije, jahte, tragete dhe te çdo mjeti tjeter lundruar, vendas apo te huaj, marrje dhe dhenie me qera te mjeteve te ndryshme te lundrimit, kryerjen e sherbimeve per permiresimin e infrastruktures portuale dhe ate te pastrimit detar, infrastruktures ujore lumore dhe liqeneve. Montimin, ngritjen e impianteve dhe venien ne shfrytezim te mjeteve te mekanizuara, te vinçave per ngarkim shkarkim te mallrave ne porte detare, vendosjen e impianteve te mekanizuara ato te sistemit hidraulik dhe elektronik sipas kerkesave te teknologjise bashkekohore aplikative ne sektorin industrial dhe detar, dhenien e asistences per zbatim e rregullave te sigurimit teknik te punonjesve, te specializuara ne dege te ndryshme te sistemit portual detar dhe atij ujor, si per 2 interesat e shoqerise dhe per ato ne interes te treteve. Projektim dhe realizim per kryerjen e sherbimeve teknike periodike ose ekstra me personel te specializuar dhe me bazen materiale teknike te veten ose te te treteve me qellim riparimin e çdo difekti te mjeteve te ndryshme detare e lundruese te çdo tonazhi dhe sigurise brenda garancise teknike, kryerje punimesh saldimi, riparime mekanike dhe motorrike, te tapicerive te anijeve dhe trageteve, kryerjen e kontroleve teknike te hangarit, mjeteve te mekanizuara te gjendjes motorrike te aparaturave matese dhe peshoreve te anijeve te transportit per mallra dhe dhenien e asistences teknike, kryerjen e sherbimit " Carteing " per vehte dhe per te trete. Krijimin dhe zhvillimin e rregullt te kurseve per edukimin dhe trajnimin navigator dhe personelit dhe te punonjesve ndihmes, per te mundesuar pergatitjen e tyre profesionale me njohurite e sherbime teknike te menaxhimit te sherbimit navigator, perfshire dhe ate te trajnimit te personelit te brendshem si dhe çeljen e nje



shkolle te mesme per Navigator. Ndertimin e urave, çeljen dhe ndertimin e rrugeve te reja, te autostradave te komunikacionit urban dhe interurban, asfaltimin e tyre, si brenda vendit dhe jashte shtetit, kryerjen e veprave te artit dhe mirembajtjen si dhe permiresimin e tyre ne perputhje me infrastrukturen bashkekohore. Kryerjen e punimeve per prodhimin dhe montimin e konstruksioneve metalike te çdo lloji dhe mikse, tregetimin e tyre me shumice e pakice, importin e makinerive dhe paisjeve teknologjike dhe venien ne shfrytezim te linjave dhe reparteve per prodhime konstruksioni metalike dhe dhenien e asistences teknike per to.. Ndertime mbrojtese e punime sistemimi kunder grryerjeve lumore, liqenore, detare, te rezervuareve pellgmajtese, kryerje punimesh per germime dheu me mjete te mekanizuara, hapje tunelesh dhe kryerje punimesh avancimi dhe perforcimi ne to, te prodhimeve pilote dhe elementeve te tjera betonarme, prodhim guri per skolierat ne ndertimet portuale, punime çimentimi dhe te injektimeve detare, shtrirje kabllosh e tubacionesh nenujore etj. Marrjen pjese ne panaire kombetare dhe nderkombetare, qe kane te bejne me çeljen dhe zhvillimin e biznesit, ne fushat e objektit te veprimtarise se parashikuar ne kete akt themelimi, me per te mundesuar arritjen e marreveshjeve kontraktore te bashkepunimit dhe kooperimit dhe me persona te tjere juridik vendas dhe te huaj per zgjerimin e aktivitetit te perbashket tregetar me to, si dhe pjesemarrjen ne tendera brenda e jashte vendit.

8. Sherbime kontabiliteti. Sherbime per pergatitjen e pasqyrave financiare ose raporteve financiare. Sherbime per keshillime ne fushen e tatim taksave. Sherbime per keshillime financiare. Sherbime per keshillime ne raport me kuotat, aksionet apo tregtimin e tyre. Sherbime ne rolin e likuidatorit ne personat juridike. Sherbime si ekspert kontabiliteti ne proceset gjyqesore. Sherbime vleresimi te pasurish te paluajteshme. Sherbime si ekspert vleresues pasurish ne procese gjyqesore.

9. Sherbime konsulence ligjore dhe asistence per personat juridike dhe fizike ne fushen civile, penale, administrative, bankare, tregtare, rregullat e prokurimeve publike dhe koncensioneve. Konsulence dhe sherbime ne te drejtat e konsumatorit apo te drejtat e sigurimeve shoqerore, shendetsore apo te punesimit, te drejtat e emrit dhe te autorit. Mbrojtja e te drejtave me pasoje demshperblime ne fushen e sigurimeve dhe ne te gjitha format e demshperblimit si rrjedhoje e demit te shkaktuar. Konsulence dhe informacion biznesi, konsulence per shoqerite tregtare dhe OJF-te, konsulence ne fushen e licensimit per te gjitha kategorite e ushtrimit te lire te profesionit. Konsulence e plote ne procedurat ligjore te regjistrimit per kompani shqiptare dhe te huaja. Perfaqesim ligjor dhe asistence gjate procedurave gjyqesore dhe te ekzekutimit te vendimve gjyqesore. Shoqeria mund te kryeje çdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, si dhe mund te kryeje çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj.

NENI 9

Me qellim arritjen e objektivit te shoqerise, ajo ka te drejte te merret me gjithëçka qe ka lidhje me objektin e saj, duke permbushur te gjitha veprimet tregtare, per pasurite e paluajteshme dhe te luajteshme, financiare e bankare, edhe me veprime te zbuluara (perjashtuar mbledhjen e fitimit), duke pranuar pjesemarrjen ne fitim si dhe marrjen pjese ne shoqeri te tjera dhe siper marrje me objekt veprimtarie analog, te ngjashem ose te lidhur me te, qofte direkt, qofte indirekt.

NENI 10

Shoqeria e fiton personalitetin juridik nga dita e paisjes me Çertifikaten e Identifikimit te personit te Tatueshem (NIPT) nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.



KREU II :

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqeria çel Llogari Bankare ne lek vendi dhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shtetere, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

Ortaku si dhe Administratori i Pergjithshem te caktuar ne Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise, depoziton specimentin e firmes origjinale ne bankat ku eshte çelur llogaria dhe veprimet bankare kryhen me firmen e ortakut per veprimtarine e zakonshme financiare kryerja pagesave, likudimeve me furnitoret jashte e brenda vendit te detyrimeve fiskale shtetere si tatimore, doganore, sigurimeve Shoqerore e shendetesore, TVSH.

Ndersa ne rastet e kryerjes se **veprimtarive te rendesishme** qe kane te bejne me shpenzime ne vlera te medha dhe te jashtezakoneshme, qe lidhen me transkaksione qe kane te bejne me blerje te pasurive te paluajtshme, shkembime apo cdo lloj tjetersimi te tyre, zmadhime te kapitalit ne likuiditet apo ne natyre, venie garancie hipotekore apo bankare, ato per çelje dhe marrje kredie, per marrje pjese ne tendera brenda vendit apo nderkombetare, Administratori i Pergjithshem i **emeruar** kryen veprime bankare vetem mbi bazen e Vendimit me shkrim te Mbledhjes se Asamblese.

NENI 12

Administrator i Pergjithshem i Shoqerise, emerohet ortakut **FLORJAN DOMI** per nje periudhe 5-vjecare, bazuar ne nenin 95 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 13

Pjeset e Kapitalit Themelor, jane ne likuiditet, nominative dhe lirisht te transferueshme ne mes ortakeve dhe rruge trashegimie sipas dispozitave te Kodit Civil.

Ortaku gezon te drejten e shitjes apo transferimit te kuotave qe zoteron, personave te tjere fizik apo juridik, jashte ortakerise, vendas ose te huaj.

Shitja apo transferimi i kuotave tek te tretet behet me akt noterial.


NENI 14

Ortaku, ka te drejte te transferoj jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht Kontributet e tij perfshire dhe Fondet e Kontributet ne Natyre bazuar ne te drejten qe parashikon dhe lejon Ligji "Per Investimet e Huaja".

Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themelor, duhet te jene te vertetuara me Akt Noterial dhe per nje gje te tille ortakut duhet ta vendosi paraprakisht me Vendim me shkrim.

Shoqeria dhe te tretet, duhet te respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.

NENI 15



Kapitali Themeltar i Shoqerise mund te rritet ose zvogelohet, mbi bazen e Vendimit me shkrim te marr unanimisht ne mbledhjen e Asamblese, i cili nenshkruhet nga ortaku dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne rregjistrin perkates.

Çdo Vendim i Asamblese per ndryshimin e Kapitalit themeltar i dergohet menjihere Qendres kompetente qe e ka njohur dhe rregjistruar Shoqerin Person Juridik.

Me Vendim te Asamblese, ne dispozicion te Shoqerise mund te vihen dhe fonde te tjera financiare duke perfshire dhe shtesa me ane te Kapitalit ne Natyre.

NENI 16

Zmadhimi i Kapitalit Themeltar, mbi bazen e Vendimit me shkrim te Asamblese, behet kur me pare Ortaku ka deklaruar, nenshkruar dhe derdhur vullnetarisht pjesen e Kapitalit qe kerkon te zmadhoj, si ne formen e Kontributit ne valute ose leke dhe ne natyre.

Nuk konsiderohen zmadhim i Kapitalit themeltar, kontributet e sherbimeve te ortakut.

Pas marrjes se vendimit per zmadhimin e Kapitalit Themeltar, Ortaku duhet te marri vendim me shkrim dhe per te pasqyruar nje rrethane te tille ne Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise.

NENI 17

Ashtu sikurse dhe ne rastin e zmadhimit dhe kur behet *zvogelimi i Kapitalit* Themeltar, merret Vendim me shkrim nga Mbledhja e Posaçme e Asamblese se Ortakeve dhe zvogelimi i Kapitalit themeltar e prek Ortakun ne ate raport te pjeses se Kontributit qe ai perfaqeson ne krijimin e Kapitalit Themeltar.

Ne rastin kur Asambleja e Ortakeve vendimin per Zvogelimin e Kapitalit themeltar e merr per shkakun se humbjet e Shoqerise arrijne nen limitin e parashikuar dhe lejuar nga Kodi Tregetar per Shoqerite me ortakeri me pergjegjesi te kufizuar, krahas vendimit per zvogelimin e Kapitalit Themeltar, ortakët duhet te marrin Vendim dhe per te percaktuar:

- a. Nevojen e ndryshimit te formes juridike te Shoqerise, duke kaluar ne nje forme tjetër.
- b. Ndryshimin e Aktit te Themelimit dhe te Statutit te saj.
- c. Te bejne publikimin dhe njoftimin e te treteve, me te cilet Shoqeria ka mardhenie kontraktore si dhe te kreditoreve te saj.

NENI 18

Si ne rastin kur Ortaket, marrin Vendim me shkrim, per zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit Themeltar, keto ndryshime duhen pasqyruar dhe ne Aktin e Themelimit dhe ne Statut dhe pasi te jene legalizuar per bazueshmerin ligjore dhe autenticitetin e nenshkrimeve para nje NOTERI, dhe ato i dergohen menjihere per Depozitim QKR-se, per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin tregetar te Shoqerive Tregtare.

KREU III :

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE DHE TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEV

NENI 19

ORGANET DREJTUESE te Shoqerise jane:

1. Asambleja e Ortakeve (e zakonshme dhe e jashtezakonshme).
2. Administratori i Pergjithshem i Shoqerise.



NENI 20

Mbledhja Asamblese se Ortakeve, eshte Organi i vetem me i larte Drejtues e Vendimor i Shoqerise dhe ushtron te gjitha kompetencat qe i njeh Ligji "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" Asamblese se Ortakeve.

Ortaku kryen Drejtimin dhe Administrimin e Shoqerise, duke respektuar legjislacionin tregetar ne Fuqi si dhe te drejttat dhe detyrat e percaktuara ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut.

Ortaku mund t'ja delegoj Kompetencat nje ose me shume Administratoreve te caktuar me vendim te Asamblese se Ortakeve, si dhe nje Personi fizik jashte ortakerise se Shoqerise, shtetas shqiptar ose i huaj mbi bazen e prokures, te bere me akt noterial.

NENI 21

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqiptar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjetere tregtare si brenda vendit dhe jashte shtetit, te zgjerroj objektin e veprimtarise se saj etj.

NENI 22

Ortaku i Shoqerise ka dhe keto te drejta dhe detyra kryesore:

* Te marri pjese ne Drejtimin dhe administrimin e gjithanshem te veprimtarise ekonomiko tregtare te Shoqerise dhe te çdo veprimtarie tjetere te saj, kur ajo ushtrohet ne perputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

* Te kerkoj dhe ta jepi te gjitha informatat qe ka te bejne me gjendjen tregtare dhe financiare te veprimtarise se Shoqerise, si dhe i te gjitha dokumentave te perpunuara nga Shoqeria, ato qe kane te bejne me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik te bilancit Kontabel apo per çdo llogarie te çelur, si te asaj Likuiduese dhe asaj Rrjedhse.

* Te mari pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne çfaredo forme apo sasi, sipas kontributit te dhene prej tij.


* Te kryej sherbime per realizmin e objektiveve dhe qellimeve te veprimtarise se rregullt ligjore te Shoqerise

* Me Vendim te Asamblese, Ortaku emeron dhe shkarkon ne çdo kohe Administratorin e Shoqerise, si dhe Ekspertin Kontabel te autorizuar.

* **Ortaku** si kryesisht dhe me ane te Administratorit te caktuar prej tij dhe kur ky i fundit eshte dhe i paisur me prokure, ushtron dhe keto Tagra (te Drejta):

Mundesohen per te kryer te gjitha aktet dhe veprimet juridike qe konsiderohen se jane te domosdoshme per ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures te veprimtarise tregtare te Shoqerise sipas qellimeve dhe objektiveve te saj siç mund te jene:

1. Te lidhin Kontrata te ndryshme qe kane per objekt Blerjen, shitjen, kembimin dhe marrjen me qera te Pasurive te ndryshme (te luajteshme dhe te paluajteshme), ate te servitutit, uzufuktit Enfiteozes, Franchising, Siper marrje Ndertimi, etj si me persona fizike dhe me Persona juridike vendas apo te Huaj, me shtetin dhe ne rastin e blerjes te Pasurive te Paluajteshme apo marrjen e tyre me qera per nje kohe mbi 9 vjet, si dhe te Kontratave te Servitutit, Uzufuktit dhe Enfiteozes, duhet te bejne rregjistrimin Hipotekat e ZVRPP te



rrethit te juridiksionit perkates si per transkriptimin e Pronesise ne favor te Shoqerise apo kalimin e kesaj pasurie ne posedim ligjor.

Çdo blerje e pasurive te mesiperme, konsiderohet dhe si shtese e Kapitalit ne Natyre.

2. Te kryejne çdo lloj veprimi prane te gjitha Zyrave shteterore dhe Private, BANKAT e çdo niveli etj, qe kane te bejne me garancite, Siper marrjet, marrjen e Kredive, te Siguracioneve dhe Risiguracioneve per jeten dhe Demet, Transportit (brenda vendit dhe jashte shtetit) kryerjen e veprimeve doganore per zhdoganimin e mallrave te importuara deklarimin e atyre te eksportuar, plotesimit ne kohe dhe me rregullsi te dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj.

Ne rastet kur Veprimet juridike kryhen nga Administratori i emeruar nga Ortaket ose personi qe Perfaqeson njeri nga Ortaket mbi bazen e Prokure, keta jane te detyruar qe ne perfundim te realizimit te veprimit perkates te njoftojne menjihere dhe ti japin llogari Asamblese se Ortakeve.

3. Administratori ose perfaqesuesi me Prokure, jane individualisht pergjegjes ndaj shoqerise apo te treteve, per veprime te kryera ne shkelje te ligjeve dhe qe bien ne kundërshtim me kete STATUT dhe per demin e shkaktuar me FAJ, sipas rastit, çdo Ortak mund te ngrej padi Civile dhe te kerkoj ndaj tyre shlyerjen e plote te demit te shkaktuar, perfshire dhe fitimin e munguar, duke patur njekohesisht dhe te drejten per te bere kallxim per ndjekje penale ne Prokurorin e juridiksionit tokesor perkates.

NENI 23

Perfaqesimi i Shoqerise, ne mardheniet me te tretet si brenda vendit dhe jashte shtetit si rregull dhe pergjithesisht i perket Administratorit te shoqerise.

NENI 24

Ortaku dhe Administratori i Shoqerise, i emeruar nga Ortaku ka te drejte qe per nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te Shoqerise, te marrin ne pune specialiste dhe shtetas te ndryshem madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, duke lidhur Kontraten sipas kriterëve qe parashikohen ne Kodin e Punes ne fuqi dhe shtesat e mepasme plotesuese te tij dhe me Ligjin Nr.7703 dt.11.05.1993 "Per Sigurimet Shoqerore" si dhe ne perputhje me rregullat teknike dhe te disiplines profesionale te caktuara nga ana e punedhënesit.

KREU IV

BILANCI, te ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 25

Veprimet ekonomiko financiare te Shoqerise, mbyllën me daten **31 Dhjetor** te çdo viti.

Nxjerrja e Bilancit financiar vjetor, behet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes, nga data e mbylljes se vitit financiar.



Per nxjerrjen e rezultatit Kontabel te Shoqerise, mbi bazen e Aktivit dhe Pasivit nga me vendim te Ortakut caktohet nje Ekspert Kontabel i Autorizuar.

Eksperti ka per detyre te kontrolloj dhe verifikoj te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise Ekonomiko tregtare te Shoqerise, si ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille mbi bazen e **Vendimit** te marre nga Ortaket e Shoqerise.

Ne perfundim te Kontrollit, Eksperti kontabel i autorizuar pergatit Raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatatit perfundimtar te Bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqes dhe dorezoi ne kohe Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve, i cili eshte Organi i vetem per ti shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

NENI 26

Nxjerrja e rezultateve te Bilancit vjetor, duhet bere me saktesi dhe duke respektuar te gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre te sistemit te Tatim Taksave qe jane te detyrueshme per tu zbatuar nga çdo subjekt privat qe ushtron veprimtari tregtare.

Eksperti Kontabel i autorizuar perveç te drejtave, ka dhe keto **detyrime**:

1. Garanton Asamblen e Ortakeve se llogarite vjetore jane te rregullta dhe Bilanci eshte nxjerre me saktesi dhe konform rregullave te Ligjit "Mbi Kontabilitetin".

2. Te pasqyroj me vertetesi rezultatet e operacioneve te vitit te kaluar financiar dhe gjendjen reale financiare te Shoqerise ne mbylljen e vitit financiar te aktivitetit tregtar te saj.

3. Te verifikoj perputhjet me llogarite vjetore te Informacioneve te dhena nga Administratorit e Shoqerise ne Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve, duke perfshire dhe dokumentat per gjendjen financiare qe ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblese Ortakeve.

4. T'i beje te njohur Ortakeve dhe Administratorit te Shoqerise:

Kontrollet dhe verifikimet qe jane bere prej tij per kontrolle periodike ose vjetore, duke vene ne dukje parregullsite apo pasaktesite e konstatuar, masat ligjore per rregullimin e tyre etj.

NENI 27

Eksperti Kontabel i autorizuar eshte pergjegjes ndaj Shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demeshme te shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregtar te Shoqerise, por nuk eshte pergjegjes kur keto DEME shkaktohen pa dijenin e tij dhe nga veprimet me faj te Administratorit te Shoqerise.

NENI 28

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim te marre nga ortaket ne mbledhjen e asamblese se ortakeve, ne te cilen jo vetem qe dokumentohet aprovimin e tij por dhe qe percakton dhe ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore, sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te aktivitetit te shoqerise por dhe per garantimin



e veprimtarise se rregullt te saj, duke patur parasyesh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit te veçante etj

Per Formimin e fondit rezerve, qe emertohet "*Rezerve e domosdoshme*" Ortaket vendosin qe nga fitimi i akumuluar gjate vitit financiar, pasi te zbriten humbjet e vitit te meparshem, te lere te pakten *1/20 e vleres* se Fitimit te realizuar.

NENI 29

Te ardhurat neto (dividenti) qe mbeten pas veçimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e çdo detyrimi tatimor e fiskal apo likuidimin e pagesave ose ekzekutimin e detyrimeve (debive) ndaj te treteve, i kalojne ne pronesi, Ortakeve ne raport me perqindjen e Kontributit financiar qe ata kane dhene ne krijimin e Kapitalit Themeltar.

NENI 30

Shperndarja ose prishja e shoqerise, mund te behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar Shoqeria siç mund te jene:

- a. Humbja e Kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshe me te veprimtarise se saj.
- b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga Ligji "*Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare*"
- c. Me kerkesen e njerit Ortak dhe kur kjo pranohet nga Mbledhja e Asamblese se Ortakeve.

Ne kete rast Ortaku, merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon dhe menyren e likudimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe leshuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "*Shoqeri ne likuidim e siper.*"

NENI 31

Akti i emerimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne aneksin e rregjistrimit Tregtar.

NENI 32

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korekt si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cilave Shoqeria eshte Kreditore dhe per ekzekutimin e plote te detyrimeve (debive) qe Shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te veçante, apo personave fizike ose juridik vendas apo te huaj.

NENI 33

Çdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht Ortaku duhet ta zgjidhi ne mirekuptim ne te kunderten çeshtjen mund ta bejne objekt Konflikti gjyqesor.

NENI 34

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet udhezimeve plotesuese e konform akteve ligjore e nenligjore ne fuqi, te dhena nga ana e Ortakute te Shoqerise si dhe hapsirave juridike lejuese te Legjislacionit ne fuqi dhe normave nderkombetare.



NENI 35

Ky Statut u redaktua ne 3(tre) ekzemplare ne gjuhen shqipe dhe me permbajtje e vlere te njejta juridike dhe pasi lexohet, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i Shoqerise tregtare **'D.F.S MARINE GROUP LTD'**Sh.P.K dhe nenshkruhet prej tij ne te gjitha ekzemplaret duke u vene emri, mbiemri dhe firma origjinale.

**ORTAKU THEMELUES
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

"D.F.S MARINE GROUP LTD " SH P K

Miratues i ketij Statuti
Shtetasi SHQIPETAR

Z. *Florian Dami*